



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 2307 Prot.  
/3

Tirane, me 11.04 2017

## DEKLARATE MJEDISORE

*per Vleresimin Strategjik Mjedisor*

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, leson kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani i Pergjithshem Vendor per Bashkine Himare

Kerkuesi: Bashkia Himare

Kufijte e zones qe mbulon plani: e gjithe siperfaqja e bashkise Himare se bashku me njesite e saj administrative.

### Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklarata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjisacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

### Qendrimi i Ministrise:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapesinore dhe duke zbatuar te gjitha masat e nevojshme zbutese, te gjitha grup-projektet jane te pranueshme nga kendveshtrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese te interesit ka kontribuar ne cilesine e vleresimit, ka sjelle te dhena per analizen dhe raportin e VSM-se dhe do te mbeshtese zbatimin e planit pas miratimit te tij, si dhe do te kontribuoje ne nje pranim me te lehte dhe me te zbutur te projekteve perkates.

### Ndikimet e mundshme ne mjedis te planit

Gjate zbatimit te projekteve/veprimeve, priten te ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet positive priten per ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe per popullatat dhe asetat materiale. Vleresimi i rezultateve tregon se nuk do te kete impakte mbi faktoret klimatike duke konsideruar qe mjetet e transportit do te vijojne te rinovohen ne te ardhmen edhe me tej, gje qe do te sjelle si pasoje permiresim te cilesise se ajrit dhe cilesise se shendetit human, midis te tjera. per me tej ne pjesen positive te impakteve mbi popullaten dhe asetat materiale do te vije si rezultat i zbatimit te infrastruktureve ne per gjithesi qe do te beje te mundur pakesimin e kohes se udhetimit, sigurine ne levizje, perafimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe sherbimet publike ne per gjithesi.

Pergjithesisht, shumica e impakteve negative jane te lidhura me fazen e planifikimit (pozicionimi i infrastruktureve ne hapesire dhe per gatitja e kushteve teknike te pershtatshme), pasi Shqiperia ka vecori te theksuara diverse dhe te shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi qe mund te ndikohen konsiderueshem prej zhvillimeve te infrastruktureve, sidomos atyre me shtrirje te gjere dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, uje, etj.). Impaktet negative shfaqen ne fazen e planifikimit prej aspekteve te per dorimit te tokes, efekteve ne uje, natyre (si biodiversiteti edhe zonat me status te mbrojtur), trashegimine kulturore dhe peisazhin. Keto impakte do te kerkojne krijimin e nje programi bashkekohor mbi masat zbutese dhe nje zbatim te pershtatshem te ketyre masave. Impakte negative mbi shendetin human mund te ndodhin per shkak te rritjes se ndotjes nga zhurmat dhe impaktet ne cilesine e ajrit, vecanerisht ne zonat me densitet te larte banimi ku do te perqendrohen edhe nje seri veprimesh ne territor te ngushte dhe kjo do te ndikoje kryesisht ne fazen e zbatimit te projekteve specifike.

### Vleresimi i perputhshmerise se objektivave:

Jane perpiluar nje grup prej 18 objektivash te VSM-se te cilat jane per dorur per:

Vleresimin e efekteve te pritshme mjedisore dhe shendetesore te skenareve alternative.

Vleresim ne detaje efektet e pritshme mjedisore dhe shendetesore te skenareve te planit lokal dhe projekteve.

Strukturimi i sitemit te propozuar te monitorimit te VSM-se

Objektivat jane ne perputhje me Direktivave e BE-se dhe legjislacionit shqiptar dhe ato janë te lidhur me objektiva nderkombetare te zhvillimit te qendrueshem dhe objektivave kombetare te mjedisit dhe Planifikimit te Territorial.

### Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjithe fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga

marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve perjegjese per mbrojtjen e mjedisit.

- Bashkia Himare, nen mbikqyrjen e Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit, qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te planit mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte eficiente ne perdonimin e energjisë, si perdonimi i teknologjive izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdonimit te ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore te parashikuara ne Plan te sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri dhe rritjen e perfitimeve per perdonuesit e kesaj infrastrukturë.
- Plani duhet te nxite realizimin e projekteve te impianteve te trajtimit te ujave te perdonur urbane dhe ne nje shkalle me te gjere duke e shtrire kete mase edhe ne aktivitete e tjera industriale qe krijojnë shkarkime ujrash industriale te ndotura dhe qe ndikojnë sidomos ne cilesine e ujave siperfaqesore dhe nentokesore. Te projektohet infrastruktura bashkekohore dhe afatgjate te kanalizimeve te ujave te ndotura urbane.
- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me kuadrin ligjor per mbrojtjen e natyres, duke respektuar shkallen e mbrojtjes se zones apo nenzones se mbrojtur ku do te nderhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve qe gjenden ne zone, si dhe te komunikohet/bashkepunohet me AKZM per te marre masat e domosdoshme per mos cenimin e statusit te ketyre zonave.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te projekteve/aktiviteve specifike individuale te Planit duhet te perfshihen masa qe do te lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore. Ne rastin kur projektet qe do zbatohen mund te prekin zona te Mbrojtura apo mund te ndodhen ne afersi te tyre.
- Plani te marre masa per promovimin e transportit publik te pasajereve qe te kontribuojne ne pakesimin e shkarkimeve ne ajer.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktureve, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Ne asnjë rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te zonave te mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet ne ajer dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nen mbrojtje. Promovimi brenda dhe ne periferite e zonave te mbrojtura duhet te jete ngritura e infrastrukturave te lehta qe mbeshtesin aktivitetet pa makina, ne drejtim te sporteve dhe aktiviteve ne natyre.
- Hartimi i planeve te menaxhimit te trafikut krahas prioritizimit te zonave te gjelbera publike, duhet te paraprijne planet urbane te zhvillimit dhe te kene objektiva te matshme per cilesine e ajrit.
- Te merren masa per mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore qe gjenden ne zonen ne studim.
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit, vemendje e vecante te kushtohet per integrimin e zonave te sigurise nga permbytjet dhe atyre ligatinore, nderkohe qe masat e pyllezimit

te synojne stabilizimin e humbjeve e tokes nga permbytjet (te zbatohet duke perdonur lloje te bimesise autoktone qe i rezistojne edhe permbytjeve).

- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Plani duhet te parashikoje kapacitete me te medha per landfillet ekzistuese dhe se pari ndertimi i landfilleve te reja teknologjike duhet te paraprije investimet ne kete.
- Ne teresi, projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peisazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar „best practices“.
- Gjate implementimit te planit te vihen ne zbatim masat zbutese e propozuara ne raportin e VSM-se per minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative ne mjedis.

#### Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te planit eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.
- › Nese plani nuk eshte miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit te deklarates, atehere deklarata behet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj te varesise, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se plani nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin perjegjes per zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershem te zbatimit deri ne sqarimin e situates.
- › Nese pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standartet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qellim qe te permbushen standartet mjedisore.
- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.

**Lefter KOKA**



**MINISTRI**